

QKR



### KONTRATE SHITJE

Ne qytetin Korce sot me daten 31 Gusht 2009 diten e Hene, para meje noterit Mihallaq Bimbi ne zyren time qe ndodhet ne rrugen 28 Nenton, u perpilua kjo kontrate shitje pasuri e lujteshme sipas,

#### BAZA LIGJORE

Dispozitat ligjore, parashikuar nga ligji 9901 dt.14.4.2008 "Per Shoq.Tregetare", nenet 83, 705 e v. te K.Civil. Nent 16 e 17 te Statutit dhe vendimi nr.ekstra dt.26.8.2009 te asamblese ortakut te vetem te shoqerise "The Blue Star" shpk, dhe vendimet nr.1-2-3 te procesverbalit te mbledhjes se Keshillit Mbikqyres te shoqerise "Five Oaks Enterprises Limited" me seli ne Nikosia te Qipros nr.101527 date 21.6.2009 si ortake e vetme te shoqerise mesipermi..

#### PALET KONTRAKTUESA

SHITESI : SHOQERIA "FIVE OAKS ENTERPRISES LIMITED" me seli ne Lefkosa te Qipros rruga "Sofuli" Nr.2, me nr.68554 rregjistri tatimor dt.6.4.1995, (si ortake e vetme e shoqerise "The Blue Star" shpk me seli ne Korce te Shqiperise me aktivitet prodhim dhe tregetim konfeksionesh - fason).

BLERESI : ANILA ISMAIL MIÇO, shtetase shqiptare me banim ne qytetin e Korces me adresë Lagja 3 rruga "Mihal Grameno" Nr.6, me datlindjes 28.2.1970, me profesion inxhinieri ndertimi me punë administrator e shoqerise "The Blue Star" shpk.

#### TE PRANISHEM

Per perpilimin e kesaj kontrate, para meje noterit sot ndodhen te pranishem - per palen shitese perfaqesuesi i saj MAKSIM FETI HAZIZI, banues ne qytetin e Korces, i cili vepron me kete cilesi ne baze te vendimeve nr. 2-3 te mbledhjes se Keshillit Mbikqyres te shoqerise me date 21.6.2009, kurse per palen blerese eshte e pranishme vete bleresje ANILA MIÇO. Te dy personat pjesemares ne kontrate te cilat jane ne moshe madhore, te afe per te kryer veprime juridike dhe une i verifikova respektivisht nepermjet pasaportave respektive me nr. Z2016699 dhe pasaporte me nr. Z1059882

#### OBJEKTI I KONTRATES

Pasuria qe shitet eshte komplet kapitali pjesemares ne shoqerine tregetare "The Blue Star" shpk, percaktuar ne perqindje 100 %, qe perberet nga 16.000 pjese me nga 1.000 (njëmije) lek, e barabarte me 16.000.000 (gjashtembetjemetilon) lek. Shoqeria "The Blue Star" shpk. me seli ne qytetin - Korce eshte nje shoqeri tregetare qe zhvillon aktivitet privat prodhim dhe tregetim konfeksionesh (fason), e rregjistruar reguliusti ne QKR me NIPT - Nr. J73721019U - NIPT.


Aprovimi per shitjen e kapitalit eshte dhene nepermjet vendimit Nr.ekstra date 26.8.2009 te Asamblese Ortakut te vetem te kesaj shoqerie.

#### PRONESIA

Pronesia e kesaj pasurie figuron ne emer te shitesit shoqeria "Five Oaks Enterprises Limited" qe eshte ortaku i vetem i shoqerise "The Blue Star" - dhe provohet me Ekstraktin e QKR lesuar me date 26.8.2009 dhe me vendimin Nr.16708/10 date 15.7.2005 te gjykates se shkalles se pare Tirane.

#### DEKLARIMI I PALEVE

Pala shitese, pra ortaku i vetem me anen e perfaqesuesit te tij, deklaron se eshte dakord qe te ngesha komplet kapitalin pjesemares te saj prej 100 % te kuotave ne kete shoqeri qe perberet e gjitha nga pasuri e luajteshme e nenshkruar per llogari te saj, dhe kete shitje e ben per ne favorin e blerese Anila Ismail Miço, duke e garantuar se pronesia eshte e lire nga cdo lloj bare apo pretendimi nga te treteri perfundruesh përgjigjet ai vete. Gjithashtu deklaron se, me kete veprim shitje ai perjashton vreten e tij nga cilesimi si ortak i vetem i shoqerise, kurse bleresen Anila Miço nga ky moment e



njeri si ortake te vetme te kesaj shoqerie me te gjitha pasojet ligjore, juridike, administrative dhe te pronesise, qe vijnë pas kesaj.

Bleresa Anila deklaron nga ana e saj se eshte dakord te bleje prej pales shitese kompleti kapitalin 100 % te shoqerise "The Blue Star" shpk. pasuri e luajteshme e nenshkruar per llogari te asaj shoqerie, qe perben nje vlera prej 16.000.000 lek e ndare ne 16.000 pjese me nga 1000 lek sejciu, dhe keshku, perfundimisht pronon te kaloje si prona dite ortake e vetme e shoqerise "The Blue Star" shpk duke bere dhe rregjistrimet e nevojshme prane QKR.

Gjithashtu te dy palet deklarojne se - Te gjitha detyrimet tjera ndaj te treteve qe vijnë si rezultat i aktivitetit te kryer nga shoqeria "The Blue Star" shpk brenda teritorit shqiptar, do te trashegojen.

Ne menyre te theksuar palet deklarojne se bleresa nuk do te njohe dhe nuk do te pranoje asnjë lloj detyrimi tjeter qe shoqeria "FIVE OAKS ENTERPRISES LIMITED" mund te kete krijuar ne ngarkim dhe ne dem te shoqerise "The Blue Star", nga cfaredo drejtimi qe mund te vije.

#### CMIMI

Cmimi i shitjes se kesaj pasurie si me siper do te jete per 16.000.000 (gjashtembetjemetilon) lek.

#### PAGESA

Sipas deklarimit te dy paleve, pagesa e shumes 16.000.000 lek te reja qe perben cmimin e shitjes, eshte shlyer gradualisht me para ne dore jashte kesaj zyre dhe nuk ekziston ndonje pretendim i ndersjellte persa i takon kesaj pagese.

#### EFEKTET

Me nenshkrinin qe do ti bejne palet kesaj kontrate perfundimisht realizohet kalimi i pronesia se pasurise objekt shitje per ne favorin e blerese Anila Ismail Miço, e cila keteje e tutje do te perbeje ortakut e vetem te shoqerise "The Blue Star" shpk me seli ne qytetin e Korces, duke zotuer 100% te kapitalit te kesaj shoqerie dhe legitimohet te beje kerkese per rregjistrimin e kesaj kontrate dhe vendimit te asamblese ne rregjistrin tregetar prane QKR.

Kontrata do te shoqerohet edhe me nje liste te makinerive e paisjeve qe zoteron shoqeria.

#### TE FUNDIT

Kontrates i bashkelidhet kopja e proces verbalit te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise "Five Oaks Enterprises Limited" Nr.101527 date 21.6.2009, vendimi nr.Ekstra date 26 Gusht 2009 i Asamblese se Ortakut te vetem te Shoqerise "The Blue Star" shpk, dhe nje kopje e ekstraktit per gjendjen e rregjistrimit te shoqerise "The Blue Star" shpk.

Permbytjen e kontrates te shkruesi me siper ja u lexova edhe nje here vete te dy paleve kontraktuese, dite ata pasi e pranuan se eshte shkruar drejt ne fund e nenshkruan reguliusti ne pranine time ne pese redaktimet origjinale njeri nga te cilat une noteri e depozitova ne arkiven time se bashku me pullat e takses.

U aplikuan 1000 lek pulla takse ndersa tarifa e punes notariale eshte 23.000 lek.

#### SHITESI

#### BLERESI

SHOQ."FIVE OAKS ENTERPRISES LIMITED"  
Ortak e vetme e Shoq. "The Blue Star" shpk

PERF.MAKSIM FETI HAZIZI

ANILA ISMAIL MIÇO

NOTERI  
MIHALLAQ BIMBLI